

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ **BOAL** ” Sh.p.k

Sot me date 24.01.2022

Z.Ajet Aluku,qytetar shqiptar,I biri I Xhevdetit i ditelindjes 25 nendor 1982,lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikuar me nr personal I21125085G
z.Sefer Boca, qytetar shqiptar,i biri i Xheladinit i ditelindjes 06. Maj 1951,lindur ne Macukull Burrel banues ne Fier, Identifikuar me nr personal F10506102E
vendosen te nenshkruaje aktin e themelimit te meposhtem per nje shoqeri te kufizuar,aktiviteti I te ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe statute I saj I cili eshte pjese perberese e ketij akti themelimi I cili bashkengjitet(referuar si shtojca 1).

Neni 1

Emertimi I Shoqerise eshte “ **BOAL** ”Sh.p.k (me poshte referuar si “Shoqeria”).

Neni 2

Selia ligjore e Shoqerise eshte ne adresen: Rruga "Aluku" Nr 57, Fshati Kashar Tirane, Shqiperi.

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise eshte pa afat duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar te Shoqerive ne Qendren kombetare te Regjistrimit.

Neni 4

4.1 Shoqeria do te kete per objekt aktivitetet e meposhtme:

- Aktivitetet ne fushen e ndertimit per zbatim: Ndertime shume kateshe civile, industriale, turistike, bujqesore, duke perfshire prodhim, tregetim te materjualeve te ndertimit, tregtim inertesh- gure, germime dhe punime dheu, sistemi dhe tarracime terrenesh, punime murature dhe beton armeje, ndertime dhe rikonstruksione veprash publike dhe private, ndertime hidrocentralesh dhe objekte te ndryshme civile, industruale, ekonomike, turistike dhe bujqesore, ndertime rruges, ndertime urash vepra arti.

- Gjithashtu shoqeria ka si objekt veprimtarie shkembimin, blerjen, shitjen, dhenien me qera, menaxhimin dhe administrimin e pasurive tepaluajtshmete vetat e te treteve lidhjet e kontratave te siper marrjes si dhe zhvillimin e tegjitha aktiviteve te lidhura direkt dhe indirekt me aktivitetin e ndertimit.

- Kekime, germime, shfrytzime, transport, perpunim
Aktivitet minerar, hapje pregatitje, cfrytezim mineraresh me punime nentokesore e siperfaqesore dhe pune me lende plasese,

Prodhim e regtim i materialeve ndertimi si prodhime inerte, betoni, betoni arme, cakell, rere, etj.

- Transport te mallrave per vehte dhe per llogari te te treteve brenda dhe jasht vendit.

- Import eksport te makinerive dhe mjeteve te transportit e ato industriale dhe tregetin e tyre. Shitje me shumice e pakice te produkteve te ndertimit dhe industriale.

Per realizimin e objektit dhe te qellimeve te saj Shoqeria mund te zhvilloje cdo lloj aktiviteti industrial, tregetar, prodhimi apo keshillimi te konsideruara te dobishme dhe te nevojshme per qellimet e shoqerise.

Neni 5

Kapitali Themeltar te Shoqerise eshte fiksuar ne 100.000 (njqindmije) leke dhe perbehet nga kontributet ne para te: Ortaket, z. Ajet Aluku dhe z. Sefer Boca kane kontribuar nepermjet derdhjes se kesaj vlere sipas certifikates bankare per derdhjen e kapitalit te themelit.

Neni 6

6.1 Kapitali themeltar eshte i ndare ne 2 (dy) pjese kapitali, te gjitha te nenshkruara dhe te paguar .

6.2 Sipas kontributeve te mesiperme kuotat zoterohen nga dy ortaket e vetem te shoqerise ne masen 50% secili te kapitalit te kesaj shoqerise.

Neni 7


Pjeset e kapitalit jane te transferueshme ndaj te treteve sipas procedurave te parashikuara nga Statuti.

Neni 8

8.1 Me ane te ketij akti emerohet si administrator i Shoqerise:

❖ Ortaku, z. Ajet Aluku , qytetar shqiptar, lindur ne Tirane, banues ne Tirane.

8.2 Administratorit ne fjale i jepen te gjitha kopetencat e nevojshme per te kryer ne menyre te pavarur te gjitha formalitetet dhe permbushjen e te gjitha detyrimeve te parashikuara per themelimin e Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi. Administratori i ka te gjitha kopetencat e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem qe perfshin objekti i Shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji ose Statuti ia rezervon



Asamblese, perfshire edhe delegimin e kompetencave edhe personve te tjere, me ane te prokures.

8.3 Ai eshte i autorizuar te veproje ne emer te shoqerise ne formim e siper deri ne regjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ai ka gjithashtu te drejte te firmose te gjitha aktet dhe te marrin persiper ne emer te Shoqerise detyrimet qe lindin nga momenti i regjistrimit te saj prane ketij institucioni dhe per tu deleguar kompetencat te veta personave te tjere me ane te prokures.

8.4 Kompetencat e tij Administratori mund tua delegoje personave te tjere me ane te prokures,per kryerjen e detyrave te vecanta.

Neni 9

Ortakeve te rinj qe mund te hyjne ne Shoqeri u kerkoet detyrimi per ruajtjen e sekretit per sa i takon dokumentacionit teknik, informacionit dhe eksperjencave te shkembhyera reciprokisht dhe per ato me te cilat ato njihen gjate zhvillimit te aktivitetit te Shoqerise.

Neni 10

Kushtet e punes ,shperblimet, oraret e punes ,pushimet dhe sigurimet shoqerore dhe ne pergjithesi maredhenia e punes midis Shoqerise dhe te punesuarve te saj do te rregullohen nga kontrata kolektive ose individuale e punes , si dhe nga Legjislacioni Shqipetar ne kete fushe.

Neni 11

11.1 Te gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin nga intepretimi, zbatimi dhe zgjidhja e ketij Akti Themelimi,si dhe mosmarveshjet qe mund te lindin midis ortakeve te ardhshem te mundshem(pervec atyre qe lindin nga raporte personale apo jasht Shoqerise) ose mosmarveshje midis ne apo me shume ortakeve dhe shoqerise,do te shtrohen per zgjidhje miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejt midis te interesuarve.


11.2 Ne rast se mosmarveshja nuk arrin te zgjidhet me mirekuptim,zgjedhja e saj do ti besohet per nje gjykate kompetente shqipatre,me kushtet qe ortaket e tjere te kene te drejte te kerkojne ne menyre alternative shtrimin e ceshties per zgjidhje prej nje kolegji arbitrash.Procedura arbitrale do te behet ne perputhje me dispozitat e parashikuara ne statut.

Neni 12

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne kater kopje me vlere te njejte.
Lexuar,nenshkruar.

Tirane,24.01.2022

Ajet Aluku



Sefer Boca

